

Letërnjoftimi i Komunës së

KAÇANIKUT

2014

Maj, 2015



Fakte


- Më 2014, Komuna e Kaçanikut kishte buxhet prej 6.5 milion eurove, një rritje prej afro 1 milion eurosh në krahasim me vitin 2013.
- Të hyrat buxhetore të Komunës së Kaçanikut për vitin 2014 kanë shënuar rritje krahasuar me dy vitet paraprake. Vetëm të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë 40% të të hyrave të përgjithshme.
- Në administratë komunale janë të punësuar 129 punonjës. Kaçaniku ka të punësuar një shërbyes civil për 262.6 banorë. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.
- Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, Kaçaniku ka 3 të punësuar me kontratë mbi vepër.
- Në sektorin e arsimit janë të punësuar 558 persona, prej tyre 455 mësimdhënës. Në Komunën e Kaçanikut raporti nxënës/mësimdhënës është 33.6. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.
- Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 115 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Kaçanikut është 294.6. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.
- Kaçaniku gjatë vitit 2014 ka pasur 3,598 persona që janë llogaritur nën skemën sociale. Krahasuar me numrin total të popullsisë në këtë komunë del se në Kaçanik rreth 11% e popullsisë të ardhurat i bazojnë në skemat sociale.
- Në Komunën e Kaçanikut funksionojnë 1552 biznese, prej tyre 466 me fushëveprimtari tregtare.
- Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 108 biznese të reja.
- Në të njëjtën periudhë, janë shuar 25 biznese, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.
- Kryetari i Kaçanikut z. Besim Ilazi gjatë fushatës zgjedhore ka dhënë 18 premtime nga fushat e ndryshme. Deri në maj 2015, shkalla e realizueshmërisë së premtimeve është 33%, mesatarja në shkallë vendi është 24%.

2 Qeverisja komunale

Edhe në zgjedhjet e fundit lokale (2013) qytetarët e komunës së Kaçanikut ia besuan votën për katër vite të ardhshme z. Besim Ilazi nga radhët e PDK-së.


Në raundin e parë në zgjedhje kanë votuar 15,439 apo rreth 48.5% qytetarë me të drejtë vote. Kryetari aktual z. Besim Ilazi ka marr 52.% të votave, ndërsa Tahir Çaka (AAK-LDD) ka marrë 17.91% të votave.

Grafikoni nr.1 Dallimi mes votave



Zgjedhjet për Kuvendi Komunal kanë nxjerr këtë përbërje: PDK 11 ulëse, AAK – LDD 5 ulëse, LDK 4 ulëse, LVV 3 ulëse PDK 2 ulëse, AKR dhe Bashkimi Demokratik për Kaçanikun nga 1 ulëse.


Grafikoni nr.2 Ndarja e ulëseve sipas partive në Kuvendin Komunal të Kaçanikut në bazë të zgjedhjeve 2013



3 Buxheti i Komunës së Kaçanikut

Më 2014, Komuna e Kaçanikut kishte buxhet prej 6.5 milion eurove, një rritje prej afro 1 milion eurosh në krahasim me vitin 2013. Pjesa më e madhe e këtij buxheti shpenzohet për paga dhe mëditje për 798 të punësuarit në arsim, shëndetësi dhe administratë. Buxheti për investime kapitale është 1.4 milion euro, një ngritje e lehtë në krahasim me dy vitet paraqake.


Grafikoni nr. 3 Buxheti total i Komunës së Kaçanikut dhe kategoritë kryesore buxhetore



Instituti GAP

Më 2014, të hyrat buxhetore të Komunës së Kaçanikut ishin afro 534 mijë euro. Të hyrat vetanake kanë shënuar rritje krahasuar me vitin paraprak.


Grafikoni nr.4 Trendi i të hyrave vetanake të Komunës së Kaçanikut 2011-2015



Instituti GAP


Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave ishte nga tatimi në pronë. Të hyrat nga tatimi në pronë përbëjnë 40% të të hyrave të përgjithshme.

Grafikoni nr.5 Kategoritë e të hyrave buxhetore




Në krahasim me komnat tjera të cilat kanë numër të përafërt të popullsisë dhe territorit, Komuna e Kaçanikut ka arritur të mbledh më shumë të hyra nga tatimi në pronë se sa komuna si Dragashi, Shtimja, Skenderaj, Hani i Elezit, etj., ndërsa më pak se sa Kamenica, Malisheva, Klina, etj.

Grafikoni nr.6 Krahasimi i komunave për nga të hyrat nga tatimi në pronë




Sa i përket shpenzimeve për dreka zyrtare, telefona mobil, telefona fiks, shpenzime për mëditje jashtë vendit, kanë shënuar rënie të dukshme në krahasim me një vit më parë, ndërsa kategoria për riparimi të veturave ka pasur një ngritje të lehtë ashtu siç mund të shihet nga figura 7.

Grafikoni nr. 7 Shpenzimet për disa kategori buxhetore



Komuna e Kaçanikut gjatë vitit 2014 ka shpenzuar për rrymë elektrike 75,024 euro, apo 4,475 euro më shumë krahasuar me një vit më herët. Edhe për mbeturina ka shpenzuar më shumë se sa një vit më herët.


Grafikoni nr. 8 Shpenzimet komunale sipas kategorive dhe viteve



4 Të punësuarit në sektorin publik


Vitin 2014 Kaçaniku e ka përmbyllur me 798 të punësuar në sektorin publik, shifër e njëjtë me atë të vitit të kaluar. Vetëm në administratë komunale janë të punësuar 129 punonjës.

Grafikoni nr.9 Numri i të punësuarve në sektorin publik në Komunën e Kaçanikut



Në administratë komunale janë të punësuar 129 punonjës. Kaçaniku ka të punësuar një shërbyes civil për 262.6 banorë. Në krahasim me popullsinë që ka, Kaçaniku ka më shumë të punësuar në administratë lokale. Mesatarja në shkallë vendi është një shërbyes civil për 278 banorë.

Grafikoni nr.10 Raporti të punësuar në administratë për kokë banori




Përveç të punësuarve me kontrata të rregullta, Kaçaniku ka edhe 3 të punësuar me kontratë mbi vepër.

Grafikoni nr.11 Të punësuar me kontratë mbi vepër




Në sektorin e arsimit janë të punësuar 558 persona, prej tyre 455 mësimdhënës. Në Komunën e Kaçanikut raporti nxënës/mësimdhënës është 33.6. Mesatarja në shkallë vendi është 29.9.

Grafikoni nr.12 Raporti nxënës/mësimdhënës në Komunën e Kaçanikut



Në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar 115 veta. Raporti punonjës shëndetësorë/popullatë në Komunën e Kaçanikut është 294.6. Mesatarja në shkallë vendi është 282.7.


Grafikoni nr.13 Punonjës shëndetësor për kokë banori



5 Ekonomia lokale

Në Komunën e Kaçanikut funksionojnë 1552 biznese, prej tyre 466 me fushëveprimtari tregtare. Gjatë vitit 2014 janë regjistruar 108 biznese të reja, një numër më i vogël se sa që ishin regjistruar në dy vitet paraprake. Pjesa më e madhe e bizneseve të regjistruara më 2014 janë biznese me fushë veprimtari tregtare.


Grafikoni nr.14 Llojet e bizneseve të reja të regjistruara më 2014



Instituti GAP

Por, në të njëjtën periudhë, janë shuar 25 biznese, numër ky më i madh sesa në dy vitet paraprake. Edhe në këtë kategori, pjesa më e madhe e bizneseve të shuara janë biznese nga fusha e tregtisë.

Grafikoni nr.15 Llojet e bizneseve të shuara më 2014



6 Premtimet

Instituti GAP ka monitoruar premtimet e dhëna nga z. Besim Ilazi gjatë fushatës zgjedhore 2013. Nga 18 premtimet e monitoruara, del se deri në maj 2015 z. Ilazi ka arritur të realizoj 33% te premtimeve. Mesatarja e premtimeve të realizuara për të gjitha komunat e Kosovës deri në maj 2015 është 24%.

Grafikoni nr.16 Premtimet e Kryetari dhe shkalla e realizimit





Instituti GAP

Rr.Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Kati 2
+381 38 609 339

info@institutigap.org
www.institutigap.org
www.komunat.institutigap.org

